



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË

BORDI

VENDIM

Nr. 27, Datë 29.01.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENER GjISË ELEKTRIKE NGA HEC “BORIE – LURE 1” ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 1800 KW.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 15/3 Prot., datë 26.01.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 259, datë 28.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vëndodhje në ujërat e përrrenjve të kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me “Njoftimin për Licencim” nr. 62/47 prot., datë 29.12.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “AGETA” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 32 prot., datë 11.01.2021, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “AGETA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/1 prot., datë 18.01.2021 dhe nr. 32/2 prot., datë 25.01.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë prodhimi të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, geramat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, geramat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC), 4.1.2 (të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin), 4.1.3 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), geramat “a”, “b”, “c”, “d”, 4.1.4 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe pika 4.1.5 (lejet nga institucionet e tjera), geramat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE brënda 3-muajve, miratimin nga MIE të shoqërisë AGETA sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese në vijim të Kontratës nr. 65 REP., nr. 38/1 KOL., datë 16.01.2018, *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Borie Lure 1”, me kapacitet prodhues 1800 kW, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, Qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë “BAJRAMI N”*.
- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Dibër (data e përfundimit 16.11.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuar, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 09.04.2022), do të kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuar një muaj pas rinovimit të saj.
- Kontrata nr. 65 REP., nr. 38/1 KOL., date 16.01.2018, *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Borie Lure 1”, me kapacitet prodhues 1800 kW, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, Qarku Dibër”, e lidhur midis MIE dhe Mbajtësit të Miratimit, Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “AGETA” sh.p.k., dhe “Bajrami N” sh.p.k., ka një afat 49- vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38, të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “AGETA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Boria Lura 1”, me kapacitet të instaluar 1800 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Shoqëria të dokumentojë në ERE brenda 3-muajve miratimin/njoftimin nga MIE të shoqërisë AGETA sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese në vijim të Kontratës nr. 65 REP., nr. 38/1 KOL., datë 16.01.2018, *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Borie Lure 1”, me kapacitet prodhues 1800 kW, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, Qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë “BAJRAMI N”.*
3. Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Dibër (data e përfundimit 16.11.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuar, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
4. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 09.04.2022), do ti kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuar një muaj pas rinovimit të saj.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe MIE për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**